

**VENDIM**  
**Nr.22, datë 10.3.2011**

**PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT TË ERE-S NR.10,**  
**DATË 18.2.2011**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.3.2011, pasi shqyrtoi shkresat e paraqitura nga shoqëritë “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe KESH sh.a. mbi kthimin e shoqërisë “Albanian Chrome” sh.p.k., për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor,

konstatoi se:

- “CEZ shpërndarje” sh.a. konfirmon se është i gatshëm t’i ofrojë shërbimin e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike shoqërisë ACR sh.p.k., duke filluar nga 15 marsi 2011, por pa përmendur kostot që mbart në vetvete ky kthim dhe marrjen përsipër të tyre.

- “CEZ shpërndarje” sh.a. pretendon që kostot shtesë që shkaktohen nga furnizimi me energji elektrike të shoqërisë “Albanian Chrome” sh.p.k. të mos i paguajë as “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe as kompania që përfiton statusin e ri, por ato të axhustohen përmes tarifës së furnizimit publik me shumicë duke e transferuar te subjektet e tjera pjesëmarrëse në tregun e energjisë, gjë që bie ndesh me modelin shqiptar të tregut të energjisë elektrike (pika 7, germa “a”) dhe rregullat e tregut shqiptar të energjisë (pika IV.2).

- KESH sh.a., me shkresën nr.1289 prot., datë 8.3.2011, rideklaron se kthimi i klientit të kualifikuar “Albanian Chrome” sh.p.k. në klient tarifor sjell pashmangshmërisht rritjen e kërkesës së “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe detyrimisht kosto shtesë për KESH sh.a. KESH-i, kërkon nga ERE, që në rast kthimi të “Albanian Chrome” sh.p.k., në klient tarifor, kostot shtesë t’u ngarkohen këtyre subjekteve në bazë të modelit dhe rregullave të tregut të energjisë elektrike.

- Përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë ACR sh.p.k. shprehen dakord me përmbajtjen e relacionit të paraqitur në mbledhjen e Bordit të Komisionerëve dhe kërkuan të jetë në diskrecionin e tyre për të vendosur nëse do ta ushtrojnë të drejtën për t’u kthyer në statusin e klientit tarifor ose jo.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Subjekti “Albanian Chrome” sh.p.k., lejohet të kthehet nga klient i kualifikuar në klient tarifor, duke filluar nga data 15 mars 2011, duke mbuluar të gjitha kostot shtesë të shkaktuara ndaj KESH sh.a. në funksionin e tij si furnizues publik me shumicë.

2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarje” sh.a. te subjekti “Albanian Chrome” sh.p.k., për periudhën nga bërja efektive e statusit të klientit tarifor deri në datën 31 dhjetor 2011, do të jetë 14.55 lekë/kWh.

3. Me bërjen efektive të statusit të klientit tarifor nga ACR sh.p.k., “CEZ shpërndarje” sh.a. do t’i paguajë çdo muaj shoqërisë KESH sh.a., diferencën ndërmjet çmimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe tarifës përkatëse të kategorisë së klientëve tariforë, ku përfshihet “Albanian Chrome” sh.p.k., të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.100, datë 7.12.2010 (14.55 lekë/kWh – 7.62 lekë/kWh të barabartë me 6.93 lekë për çdo kWh, të faturuar klientit “Albanian Chrome”).

4. ACR sh.p.k. të vendosë për statusin përfundimtar brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. ACR sh.p.k. të njoftojë “CEZ shpërndarjen” dhe ERE-n 5 ditë para ditës së bërjes

efektive të satusit të klientit tarifor.

6. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë “Albanian Chrome” sh.p.k., “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe KESH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Bujar Nepravishta**